



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.07.2024

Nr: 131

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KANDIDATIN PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, Z. PETRAQ EPAMINONDA GJIKURIA,
KANDIDAT I PROPOZUAR NGA KOALICIONI BASHKË FITOJMË, PËR
ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4
GUSHT 2024**

Sot, më datë 26.07.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

Objekti: Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Himarë, z. Petraq Epaminonda Gjiguria, të propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” (BF), për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 33, shkronja “f” i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja “a”, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VËREJ:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar pranë KZAZ nr. 88 formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Himarë z. Petraq Epaminonda Gjiguria.

Data: 26.07.2024 Nr: 131
Ora: 12:00



“Për verifikimin e kushteve të kandidimit për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Himarë, z. Petraq Epaminonda Gjiguria kandidat i propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” (BF), në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga KZAZ nr. 88 është përcjellë formulari i vetëdeklarimit të kandidatit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për kryetar të bashkisë Himarë, për zgjedhjet e pjesshme të datës 4 Gusht 2024.

Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Himarë rezulton se, të dhënat e deklaruara nga kandidati nuk përfshihen në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja “b” e 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatin për kryetar të bashkisë Himarë, z. Petraq Epaminonda Gjiguria, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Petraq Epaminonda Gjiguria, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati për kryetar bashkie për bashkinë Himarë, z. Petraq Epaminonda Gjiguria, i propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk përbën kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024.

Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ duhet të vazhdojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 33, shkronja “f” i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja “a”, i ligjit nr.

Data: 26.07.2024 Nr:131
Ora: 12:00



“Për verifikimin e kushteve të kandidimit për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Himarë, z. Petraq Epaminonda Gjiguria kandidat i propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” (BF), në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë himarë të datës 4 Gusht 2024”.

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatin për kryetar bashkie z. Petraq Epaminonda Gjiguria për Bashkinë Himarë, të propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” (BF) dhe lejimin e kandidimit të tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI